

Nr. Prot. 056/B/19

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS		
Nr./Br./No.	0561B/19	
Nr. Faq./Br. St./No. Pg.	3	
Datë/Datum/Date	07.06.2019	
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISHTINA		

VENDIM Nr. 1388

Për

Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik të dokumentit

“Ripërtirirja e Autorizimeve individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 dhe 1800MHz për operatorët Telekom i Kosovës sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC”

Në mbështetje të nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.6), nenit 10, paragrafi 4) dhe 12), nenit 45 paragrafët 1) dhe paragrafi 2), nenit 54 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 4), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar |

pas shqyrtimit të dokumentit të përgatitur nga Grupi Punues sipas Vendimit Nr.1382 (Ref. Nr.Prot.052/B/19), vendosi si më poshtë:

VENDIM

- I. Miratohet fillimi i konsultimit publik të dokumentit: **“Ripërtirirja e Autorizimeve individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 dhe 1800MHz për operatorët Telekom i Kosovës sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC”**, i cili i është bashkangjitur këtij vendimi.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **07 Qershor 2019** dhe përfundon më datë **21 Qershor 2019**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Faqe 1 nga 3



ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 45, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se: *"Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio – frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio – frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime."*

Neni 54, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se ARKEP vendos kushtet për shfrytëzimin e radio-frekuencave.

ARKEP përmes dokumenteve të hartuara dhe publikuara në WEB faqen e tij si në vijim:

- Plani për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT" (*Nr. Prot. 047/B/19 Dt. 08/05/2019*),
- Dokumentit "Konkluzione nga këshillimi publik i dokumentit - Plani për hapjen e brezeve" (*Nr. Prot. 048/B/19 Dt. 08/05/2019*),

ka informuar palët e interesit lidhur me fazat dhe afatet për hapjen e brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, **përfshirë ripërtëritjen e autorizimeve individuale** për resurset ekzistuese në brezet 900 dhe 1800 MHz në shfrytëzim nga operatorët e Telekomit i Kosovës Sh. A. dhe IPKO Telecommunications LLC, i cili pritet të realizohet në gjysmën e parë të vitit 2019 sipas metodës së drejtpërdrejtë.

Për këtë qëllim, ARKEP me Vendimin nr.1382 (Ref. Nr.Prot.052/B/19) ka themeluar komisionin për hartimin e dokumentit për ripërtëritjen e autorizimeve për operatorët në fjalë.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Prandaj, në përmbushje të objektivave të përcaktuara në:

- Ligjin Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike, i cili rregullon aktivitetet e komunikimeve elektronike, përfshirë këtu menaxhimin e resurseve frekuencore bazuar në neutralitetin teknologjik dhe Kornizën Rregullatore të BE-së,
- Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike "Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020" për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës,

Atëherë Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 07/06/2019

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit



Aktvendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Ndërmarrjeve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike
- Arkivës së Autoritetit.